

BLEDAR ÇUÇI

Datëlindja: 14.11.1970

Vendlindja: Tiranë

Email:

Telefon:

Jetëshkrimi:

Në vitin 1995, z. Çuçi përfundoi studimet e larta për Drejtësi në Universitetin e Tiranës dhe në vitin 1998, studimet pasuniversitare (Master) për Menaxhim në Universitetin Hasselt në Belgjikë.

Gjatë viteve 1996-1997 ka ushtruar detyrën e juristit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mjedisit dhe më pas në vitet 1999-2000 ka qenë oficer i Policisë Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Në vitet 2000 – 2005, z. Çuçi ka shërbyer në disa funksione drejtuese, si kancelar i Gjykatës së Rrethit Tiranë, si dhe këshilltar i ministrit, drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Integritimit dhe Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe në Ministrinë e Brendshme, Shtylla e Qeverisjes Lokale. Gjatë kësaj periudhe, z. Çuçi ka shërbyer si: përfaqësues i qeverisë shqiptare në Komitetin për Demokracinë Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Europës, Strasburg, anëtar i Grupit Negociator të Shqipërisë lidhur me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim–Asociimit mes Shqipërisë dhe Bashkimit Europian (BE) dhe anëtar i Bordit të Drejtorëve të Institutit për Trajnimin e Administratës Publike (ITAP) në Shqipëri.

Gjatë viteve 2006 – 2010, z. Çuçi shërbeu si këshilltar dhe ekspert për disa programe ndërkombëtare në Kosovë dhe Shqipëri, programe të mbështetura nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar i Mbretërisë së Bashkuar (DfID), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe BE.

Gjatë periudhës prill 2010 – nëntor 2011, ai ka qenë Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës për Autonominë Vendore në Shqipëri, ndërsa nga nëntori 2011 deri në gusht 2012, ka shërbyer si ekspert ligjor pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore në Shqipëri.

Prej shtatorit të vitit 2013 e deri në mars 2017, z. Çuçi ushtroi detyrën si ministër Shteti për Çështjet Vendore dhe Koordinator Kombëtar kundër Korrupsionit. Prej janarit të vitit 2019 deri në dhjetor 2020, z. Çuçi ushtroi detyrën e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërsa nga shtatori 2017- dhjetor 2018 ai ka qenë nënkryetar i Komisionit Parlamentar për Integrimin Evropian si dhe ka mbajtur detyrën e bashkëkryetarit të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore . Po gjatë kësaj periudhe ai ka qenë anëtar i Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si dhe ka qenë kryetar i Delegacionit të Kuvendit të Shqipërisë në Asamblenë Parlamentare të OSBE-së.

Prej shtatorit 201 e në vazhdim z. Çuçi ka përfaqësuar qarkun Gjirokastrë në Kuvendin e Shqipërisë. Nga nëntori 2019 - janar 2020 ka qenë drejtues qendror i Operacionit për Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, tërmeti i datës 26 nëntor. Nga janar 2019-dhjetor 2020

ka mbajtur detyrën e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Së fundmi, prej muajt dhjetor 2020 e në vazhdim ai mban detyrën e Ministrit të Brendshëm.

Z. Çuçi ka përvojë në mësimdhënie dhe trajnim. Gjatë periudhës 1997-2002 ka qenë Lektor për lëndët e bazës së Teorive Ligjore dhe të Kuadrit Ligjor mbi Mjedisin në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Në vitet 2004-2005 ka qenë trajnues në fushën e funksioneve të administratës publike, të decentralizimit dhe të qeverisjes lokale në Institutin për Trajnimin e Administratës Publike. Prej shtatorit deri në dhjetor 2008 ka qenë lektor i lëndës për Administrimin e Territorit në Universitetin “Marin Barleti”.